

Ri - shpall
KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

GAZETAR 2 / REDAKSIA NË GJUHËN TURKE / PROGRAMI PËR KOMUNITETE / RTK – TV

1 POZITË (Nr. 1027)

Detyrat

- Shkruan dhe përgatit lajmet për transmetim;
- Prodhon kronika duke shfrytëzuar teknikën prodhuese përkatëse;
- Është përgjegjës për burimin e informacionit dhe zhvillimin e kronikës;
- Kontribuon në planifikimin dhe mbulimin e ngjarjeve;
- Përzgjedh materiale relevante për transmetim;
- Rishkruan dhe korrigjon lajmet sipas kërkesës së eprorit;
- Zhvillon intervista në studio dhe në lokacione të tjera;
- Grumbullon njohuri të specializuara sipas nevojës;
- Mban kontakte të rregullta me palë për të siguruar informata të nevojshme për lajme;
- Prodhon, monton dhe dërgon lajme me teknologji të re smart.

Kushtet

- Kualifikimi superior profesional;
- Së paku gjashtë muaj përvojë pune;
- Njohuri e standardit të lartë të gjuhës turke në të shkruar dhe në të folur;
- Njohuri e punës në kompjuter;
- Njohuri të gjuhës shqipe;
- Njohuri e gjuhës angleze;
- kategoria " B" e vozitjes;
- Gatishmëri për të punuar me ndërrime dhe me orar të zgjatur;
- Aftësi për të punuar qetë, nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Njohje dhe interesim për programin e përgjithshëm të RTK-së;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetiniciativë.

Për këtë vend të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar, me periudhë provuese prej gjashtë muajve.

Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:

- të jenë shtetas të Republikës të Kosovës - regjistruar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- ✓ një CV;
- ✓ dëshmitë e kualifikimit të noterizuara;
- ✓ një kopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
- ✓ një kopje të patentshoferit;
- ✓ një letër motivuese;
- ✓ dy referenca;
- ✓ dëshmi të përvojës;

- ✓ dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk kanë qenë të dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepër penale të dënueshme më shumë se gjashtë muaj (të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit),
- ✓ aplikacionin i cili mund të shkarkohet nga ueb-faqja e RTK-së:
<https://www.rtklive.com/sq/docs/2022-02-05/231.doc>

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes e-mail adresës: konkurs@rtklive.com, prej 20.03.2023 deri më 03.04.2023 në orën 23:50.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.
Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merren në konsiderim.